

Në bazë të nenit 71, 72 dhe 83 të Statutit të Bashkimit Demokratik për Integrim, Komisioni Zgjedhor i Partisë, në seancën e mbajtur më \_\_\_\_\_, miraton:

**RREGULLORE**  
**për kriteret, mënyrën dhe procedurën e kandidimit**  
**dhe për zgjedhjen e organeve të BDI-së**

**Neni 1**

Kjo rregullore i përcakton kushtet dhe procedurën e kandidimit, procedurën dhe procesin e votimit, procedurën e ankimit, të drejtat dhe detyrimet e trupave për zbatimin e zgjedhjeve, të vendotimeve, shpalljen e rezultateve të votimit për procesin zgjedhor të organeve të BDI-së.

**I. ORGANET PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE**

**Neni 2**

Organet për zbatimin e zgjedhjeve janë:

1. Komisioni Zgjedhor i Partisë
2. Komisioni Zgjedhor Komunal
3. Komisioni Zgjedhor Vendor

Anëtarët e trupave për zbatimin e zgjedhjeve nuk mund të jenë kandidatë në procesin zgjedhor.

**I.1. KOMISIONI ZGJEDHOR I PARTISË**

**Neni 3**

Komisioni Zgjedhor i Partisë (KZP) zgjidhet nga Kongresi me propozim të Kryetarit të partisë, me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

KZP-ja përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë (kryetari dhe gjashtë anëtarë) në nivelin qendror të partisë, ndërsa në nivel dege dhe të këshillave vendore përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes e përcakton KZP-ja.

Kandidatë për kryetar dhe anëtarë të Komisionit Zgjedhor të Partisë (KZP) mund të propozojë edhe 1/3 (një e treta) e delegatëve të Kongresit të Partisë me pëlqim të kryetarit të partisë.

Mandati i Komisionit Zgjedhor të Partisë (KZP) zgjat 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Propozim për shkarkim të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Zgjedhor të Partisë (KZP), mund të paraqesë kryetari i partisë dhe 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm të Partisë.

Kryetari apo anëtarët e Komisionit Zgjedhor të Partisë (KZP), mund të shkarkohen me shumicë të thjeshtë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm të Partisë.

#### **Neni 4**

Kompetencat e Komisionit Zgjedhor të Partisë;

- kujdeset për përgatitjen dhe realizimin e zgjedhjeve në nivel lokal dhe në nivel shtetëror, në pajtim me statutin dhe vendimet e partisë;
- miraton rregulloren me të cilën përcaktohen kriteret për mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së organeve të partisë nën parimin një anëtar një vote;
- shkarkon secilin anëtar të Komisionit Komunal të Partisë në rast të veprimit që bie ndesh me Statutin dhe Rregulloren e partisë;
- miraton udhëzim për zgjidhje të prapësimeve dhe ankesave;
- administron Listën Zgjedhore sipas Regjistrimit Bazë të Anëtarësisë;
- e bën publike ueb-faqen (<https://regjistrim.mk/search/>) për kërkim të Listës së anëtarësisë përmes numrit amë me këto të dhëna: emri, mbiemri, datëlindja, dega dhe këshilli vendor;
- punon në mbledhje nëse në të njëjtat marrin pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve;
- miraton vendime me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit;
- gjatë marrjes së vendimeve anëtarët e KZP-së do të prononcohen me “për” ose “kundër”. Nuk lejohet prononcim me “i përmbajtur”, mirëpo edhe në rast të prononcimit të tillë, ky votim do të konsiderohet si votë “kundër”.

KZP me akt të posaçëm përcakton numrin e anëtarëve të kryesisë së këshillit vendor dhe të kryesisë së degës duke marrë parasysh nenin 18 të Statutit të BDI-së për përfaqësim të drejtë vendor dhe gjinor.

Për vendbanimiet me më pak se 50 anëtarë, mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së kryetarit të Këshillit Vendor si dhe të Kryesisë së Këshillit Vendor, KZP-ja e përcakton me akt të posaçëm, në përputhje me Statutin e partisë dhe me këtë Rregullore

## **I.2 KOMISIONI ZGJEDHOR KOMUNAL**

### **II.2.1 Zgjedhja dhe përbërja e komisioneve komunale zgjedhore**

#### **Neni 5**

Komisionet Komunale të zgjedhjeve formohen në të gjitha degët te BDI-së.

#### **Neni 6**

Komisionet Zgjedhore Komunale (KZK) zgjidhen nga Komisioni Zgjedhor Partiak me zgjedhje te rastësishme nga lista zgjedhore.

Mënyra e realizimit të zgjedhjes se rastësishme bëhet në bazë të metodologjisë së miratuar me shumicë votash nga KZP.

KZP-ja përbëhet nga 3 (tre) anëtarë (kryetari dhe dy anëtarë) në nivel dege.

Mandati i Komisionit Komunal të Partisë (KZP) zgjat 4 (katër)vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Propozim për shkarkim të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Komunal të Partisë (KZK), mund të paraqesë kryetari i komisionit zgjedhor të partisë dhe 1/3 e anëtarëve të komisionit zgjedhor të partisë.

Kryetari apo anëtarët e Komisionit Zgjedhor Komunal (KZK), mund të shkarkohen me shumicë të thjeshtë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit zgjedhor partiak.

## **1.2.2 Kompetencat e Komisionit Zgjedhor Komunal**

### **Neni 7**

1. Komisioni Zgjedhor Komunal kujdeset për organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve në pajtim me statutin e BDI-së dhe bën mbikëqyrjen e punës së komisioneve vendore.
2. Komisioni zgjedhor komunal:
  1. emëron përbërjen e komisioneve vendore me zgjedhje të rastësishme nga lista zgjedhore e anëtarisë;
  2. shkarkon anëtarët e komisionit vendor në rast të veprimit antistatutar para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve;
3. jep udhëzim për punën e komisioneve vendore;
4. shpallë listat e përcaktuara të kandidatëve;
5. bën përgatitje teknike për zbatimin e zgjedhjeve sipas udhëzimeve të Komisionit Zgjedhor Partiak;
6. informon anëtarinë për vendin e votimit;
7. evidenton dhe konfirmon vëzhguesit e autorizuar për përcjelljen e punës së Komisionit Zgjedhor Komunal dhe të komisioneve vendore dhe u jep identifikime me numrin e vendvotimit përfaqësuesve të autorizuar të cilët do ta përcjellin punën e komisioneve vendore;
8. dorëzon dhe grumbullon materialet e zgjedhjeve në komisione vendore dhe nga komisione vendore;
9. pas zbatimit të zgjedhjeve për kryetar dege, anëtarë të degëve, kryetar dhe anëtarë të këshillave vendor, i mbledh rezultatet nga votimi i listës së kandidatëve, përpilon procesverbal dhe bashkë me materialin e përgjithshëm zgjedhor, e dorëzon atë në Komisionin Zgjedhor Partiak menjëherë, e më së voni 12 orë pas përfundimit të votimit.

10. Gjatë realizimit të zgjedhjeve për kryetar dhe anëtarë të këshillave vendore:

1. verifikon nëse listat e propozuara të kandidatëve për zgjedhje të anëtarëve të këshillave vendore dhe lista e kandidatit për kryetar të këshillit vendor, janë paraqitur në pajtim me këtë Rregullore dhe Statutin e BDI-së;
2. verifikon listat e kandidatëve të propozuar;
3. ruan materialin zgjedhor nga zgjedhjet për këshilla vendore;
4. konfirmon rezultatet nga votimi në këshillat vendore për anëtarë këshillit vendor dhe kryetarit të këshillit vendor për përzgjedhjen menjëherë pas përfundimit të procesit.

### **I.3 KOMISIONI ZGJEDHOR VENDOR**

#### **Neni 8**

Komisioni Zgjedhor Vendor (KZV) zgjidhet nga Komisioni Zgjedhor Komunal me zgjedhje të rastësishme nga Lista zgjedhore e anëtarësisë.

Mënyra e realizimit të zgjedhjes së rastësishme bëhet në bazë të metodologjisë së miratuar me shumice votash nga KZP.

KZV-ja përbëhet nga 3 (tre) anëtarë (kryetari dhe dy anëtarë) nga Këshilli Vendor.

Mandati i Komisionit Zgjedhor Vendor (KZV) zgjat 4 (katër) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Propozim për shkarkim të kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Zgjedhor Vendor (KZV), mund të paraqesë kryetari i Komisionit Zgjedhor Komunal dhe 1/3 e anëtarëve të Komisionit Zgjedhor Komunal.

Kryetari apo anëtarët e Komisionit Zgjedhor Vendor (KZK), mund të shkarkohen me shumicë të thjeshtë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit Zgjedhor Komunal.

#### **I.3.1 Kompetenca e Komisionit Zgjedhor Vendor**

#### **Neni 9**

1. Komisionit zgjedhor vendor kujdeset për realizimin e zgjedhjeve në pajtim me Statutin dhe Rregulloret të miratuara nga komisioni zgjedhor partiak.
2. Komisionit zgjedhor vendor:
  1. realizon drejtpërsëdrejti votimin në vendvotim;
  2. siguron rregullsi dhe fshehtësi të votimit;
  3. siguron votim të lirë dhe të qetë;
  4. përmbledhë dhe konfirmon rezultatin nga votimi në vendvotim;
  5. rezultatet nga votimi i shpall në vendin ku është realizuar votimi;
  6. përpilon raportin dhe e dorëzon atë në Komisionin Zgjedhor Komunal.

3. Komisioni Zgjedhor Vendor përpilon procesverbal për punën dhe për mbledhjen e rezultateve në formular të vetëm të përcaktuar dhe të verifikuar me vulë nga Komisioni Zgjedhor Vendor dhe bashkë me materialin zgjedhor e dorëzon në Komisionin Zgjedhor Komunal.

4 Në rast të ndonjë gabimi gjatë plotësimit të procesverbalit, Komisioni Zgjedhor Vendor vepron sipas udhëzimit të Komisionit Zgjedhor Komunal.

4. Komisioni Zgjedhor Vendor, punët në kompetencat e tij i kryen në pajtim me këtë Rregullore, Statutin e BDI-së dhe me udhëzimet nga Komisioni Zgjedhor Partiak.

## **II. EVIDENCA E SË DREJTËS ZGJEDHORE**

### **1. Mbajtja e Listës zgjedhore e anëtarësisë**

#### **Neni 10**

Listën zgjedhore të anëtarësisë e udhëheq KZP pasi e verifikon çdo komision zgjedhor komunal dhe në fund e miraton Komisioni Zgjedhor Partiak.

#### **Neni 11**

Të drejtë vote në organizimin dhe realizimin e mbajtjes së zgjedhjeve për zgjedhjen e organeve të partisë kanë të gjithë anëtarët e regjistruar në listën zgjedhore të cilën e udhëheq Komisioni Zgjedhor i Partisë.

### **2. Përmbajtje e Listës zgjedhore dhe ekstraktet e shtypura**

#### **Neni 12**

1. Lista zgjedhore i përmban të dhënat si vijon: numrin e vetëm amë të anëtarëve (NVAQ), mbiemrin, emrin e njërit prind dhe emrin, gjininë, datëlindjen, degën, këshillin vendor, adresën e banimit (komuna, vendbanimi, rruga, numri i shtëpisë, hyrja dhe banesa), datën e regjistrimit dhe shlyerjes si dhe datën e plotësimit të të dhënave.
2. Ekstraktet e shtypura nga Lista zgjedhore dhe ekstraktet e veçanta të Listës zgjedhore, mbahen sipas alfabetit me mbiemrin e anëtarit dhe i përmbajnë këto rubrika përkatësisht të dhëna: numri rendor, mbiemri, emri, gjinia, data e lindjes, adresa e banimit (vendbanimi, rruga, numri i shtëpisë, hyrja dhe banesa) dhe vendi për nënshkrim.

### **3. Kontrolli i të dhënave në Listën zgjedhore dhe Shqyrtimi publik në Listën zgjedhore**

#### **Neni 13**

1. Çdo anëtar, gjatë tërë vitit mund të kërkojë të bëjë kontroll në Listën zgjedhore të anëtarësisë, në faqen zyrtare <https://regjistrim.mk/search/>
2. Nëse gjatë kontrollit në Listën zgjedhore të anëtarësisë konstatohet që ai/ajo nuk është i (e) regjistruar në Listën zgjedhore të anëtarësisë, ose konstatohet se duhet të bëhet regjistrimi, plotësimi ose shlyerja e të dhënave në Komisionin Zgjedhor Komunal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për regjistrimin, plotësimin ose shlyerjen e të dhënave, duke parashtruar edhe dokumentacion përkatës.
3. Komisioni Zgjedhor Partiak më së voni në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, do ta kontrollojë saktësinë e të dhënave dhe dokumenteve të ofruara nga anëtari dhe nëse konfirmon se kërkesa është e bazuar, me vendim në bazë të dokumentacionit të besueshëm do ta bëjë regjistrimin, plotësimin ose shlyerjen e të dhënave në Listën zgjedhore partiake, në të kundërtën do të miratojë vendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën.

### **4. Shqyrtim publik në Listën zgjedhore**

#### **Neni 14**

1. Komisioni Zgjedhor Partiak, pas përfundimit të afatit për regjistrim të anëtarësisë, Listën zgjedhore e ofron për shqyrtim publik në faqen e BDI-së <https://regjistrim.mk/search/>
2. Listën zgjedhore e ofron për shqyrtim publik në faqen e BDI-së me të dhëna për:
  - anëtarët të cilë kanë aderuar me regjistrimin aktiv punë kjo që bëhet nga Komisioni Zgjedhor Partiak
3. Komisioni Zgjedhor Partiak pas vënies në shqyrtim publik të ekstrakteve nga Lista zgjedhore, përmes komisioneve Zgjedhore Partiake dhe Komisioneve Zgjedhore Vendore, i njofton qytetarët për vendin ku do të bëhet Shqyrtimi publik, për mënyrën si bëhet shqyrtimi, për kohëzgjatjen e shikimit dhe mundësinë për regjistrim, plotësim ose shlyerjen e të dhënave në Listën zgjedhore të anëtarësisë.
4. Shqyrtimi publik zgjat pesë ditë pas përfundimit të regjistrimit aktiv.

#### **Neni 15**

(1) Kërkesë për regjistrim, plotësim ose shlyerje të të dhënave në ekstraktet e Listës zgjedhore të anëtarësisë, të paraqitur për shqyrtim publik, në afatin prej 5 ditësh, mund të paraqesë secili anëtar nëse:

- ai/ajo nuk është regjistruar në Listën zgjedhore të anëtarësisë;
- është regjistruar person i cili nuk ka të drejtë vote ose nuk ka vendbanim në rajonin e komunës ose person i cili ka ndërruar jetë dhe nëse
- emri personal dhe adresa e personit janë regjistruar gabimisht.

(2) Kërkesa për regjistrim, plotësim ose shlyerje të të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, paraqitet me shkrim në zyrat e Komisionit Zgjedhor Komunal ose I dërgohet me postë elektronike Komisionit Zgjedhor Partiak.

(3) Kërkesës i bashkangjiten edhe provat e duhura.

#### **Neni 16**

(1) Komisioni Zgjedhor Partiak, konform kërkesave dhe fletëparaqitjeve të anëtarëve, është i obliguar të vendosë me vendim në afat prej 24 orësh nga dita e pranimi të kërkesës dhe nëse konstaton që kërkesa është e bazuar, në pajtim me Rregulloren dhe Statutin e BDI-së me vendim do të bëjë regjistrimin, plotësimin ose shlyerjen e të dhënave në Listën zgjedhore dhe të njëjtën anëtarit do t'ia dërgojë në formë elektronike. Në të kundërtën, do të miratojë vendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën dhe të njëjtin do t'ia dërgojë qytetarit në formë elektronike.

### **5. Përmbyllja dhe nënshkrimi i Listës zgjedhore**

#### **Neni 17**

Komisioni Zgjedhor Partiak, Listën zgjedhore në të cilën janë bërë të gjitha ndryshimet që kanë rezultuar nga shqyrtimi publik, të shtypur në formë të ekstrakteve, e përmbyll më së voni 20 ditë pas përfundimit të shikimit publik dhe e njëjta nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Zgjedhor Partiak.

### **6. Mbrojtja e të dhënave në Listën zgjedhore**

#### **Neni 18**

(1) Të dhënat personale në Listën zgjedhore janë të mbrojtura në pajtim me ligjin dhe nuk guxojnë të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç se për realizimin e të drejtës së zgjedhjeve në pajtim me Statutin e BDI-së dhe me këtë Rregullore.

(2) Kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhje, kandidaturat e të cilëve janë verifikuar nga Komisioni Zgjedhor Partiak, me kërkesë paraprake me shkrim, u jepen në formë elektronike të dhëna nga ekstrakti i Listës zgjedhore i nënshkruar ose i përgatitur paraprakisht për secilin vendvotim përfshirë këshillin vendor ose degën ku garojnë.

(3) Kandidatët pjesëmarrës në zgjedhje, përkatësisht përfaqësuesit e autorizuar dhe zëvendësit e tyre të paraqitësve të listës së kandidatëve, nuk mund t'i përdorin listat zgjedhore të anëtarësisë në ditën e zgjedhjeve për evidentimin e personave që kanë votuar.

#### **Neni 19**

Komisioni Zgjedhor Partiak, gjegjësisht punonjësi i autorizuar që është i njoftuar me të dhënat personale të përfshira në Listën zgjedhore të anëtarësisë, është obliguar që t'i ruajë dhe mbrojë ato në pajtim Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## **III.1 ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KRYESISË SË KËSHILLIT VENDOR**

## **Neni 20**

Të drejtën e kandidimit në zgjedhjet për anëtarë të Kryesisë së Këshillit Vendor e gëzojnë të gjithë anëtarët e BDI-së të regjistruar, nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës, dhe që së paku janë një vjet anëtar të BDI dhe që i plotësojnë kriteret e parapara më këtë Rregullore.

## **Neni 21**

Anëtarët e Këshillit Vendor zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, të fshehta, brenda-partiake, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e BDI-së nga Këshilli Vendor i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës, të cilët janë të regjistruar në listën zgjedhore të BDI-së, në bazë të regjistrimit për anëtarësim të realizuar në përputhje me dispozitat e Statutit, të Rregullores dhe akteve të tjera nënstatutore të Partisë.

## **Neni 22**

Zgjedhja për anëtar të Këshillit Vendor realizohet me votim të fshehtë, duke zbatuar parimin një anëtar - një votë.

KZP me akt të posaçëm përcakton numrin e anëtarëve të Kryesisë së Këshillit Vendor duke respektuar nenin 18 të statutit të BDI për përfaqësim të drejtë vendor dhe gjinor.

Në paragrafin një (1) të këtij neni nuk përfshihet kryetari i Këshillit Vendor dhe kryetari i Forumit Rinor.

Anëtar i zgjedhur i Këshillit Vendor llogaritet kandidati i cili i plotëson të gjitha kriteret e parapara në aktin e veçantë të KZP-së për zgjedhjet në nivel komunal dhe lokal.

## **2. Kriteret e kandidatit për anëtar të Këshillit Vendor të BDI-së**

### **Neni 23**

Të drejtën e kandidimit në zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Vendor e kanë të gjithë anëtarët e BDI-së të regjistruar, nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës dhe që i plotësojnë kushtet e parapara më këtë Rregullore.

### **Neni 24**

Për anëtar të Këshillit Vendor të BDI-së mund të kandidohet secili që së paku një vit është anëtar i BDI-së dhe vepron në këshillin vendor në territorin e degës përkatëse.

## **IV.1. ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË KËSHILLIT VENDOR**



## **Neni 25**

Të drejtën e kandidimit në zgjedhjet për kryetar të Këshillit Vendor e gëzojnë të gjithë anëtarët e BDI-së të regjistruar, nga Këshillit Vendor i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës, dhe që i plotësojnë kriteret e parapra më këtë Rregullore.

## **Neni 27**

Kryetari i Këshillit vendor zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta, të fshehta, brendapartiake, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e BDI-së nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshillit Vendor përkatës, të cilët janë të regjistruar në listën zgjedhore të BDI-së, në bazë të regjistrimit aktiv për anëtarësim të realizuar në pajtim me dispozitat e Statutit, të Rregullores dhe akteve tjera nënstatutore.

## **Neni 28**

Zgjedhja e kryetarit të Këshillit Vendor të BDI-së realizohet me votim të fshehtë, duke zbatuar parimin një anëtar - një votë.

Kryetar i Këshillit vendor të BDI-së llogaritet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve që kanë dalë në zgjedhje ditën e votimit dhe jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të BDI-së të regjistruar në listën zgjedhore të anëtarësisë, në degën përkatëse.

## **Kriteret e kandidatit për kryetar të Këshillit Vendor së BDI-së**

## **Neni 29**

Për kryetar të Këshillit vendor së BDI-së mund të kandidohet secili person i cili së paku një vit është anëtar i BDI-së dhe nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse.

## **IV.2. PROCEDURA PËR KANDIDIM**

## **Neni 30**

Në afat prej 20 ditëve para mbajtjes së zgjedhjeve për Kryetar të Këshillit Vendor së BDI-së, anëtarët e BDI-së e dorëzojnë në KZK kandidaturën e tyre për kryetar të Këshillit Vendor të BDI-së.

Kandidatura për kryetar të Këshillit Vendor së BDI-së dorëzohet me anë të formularit të veçantë drejtpërdrejtë në KZK, me bashkëngjitje të biografisë personale dhe partiake.

Për secilën kandidaturë nevojitet pëlqim me shkrim (deklaratë) e kandidatit për pranim të kandidaturës, që është e parevokueshme.

### **Neni 31**

Komisioni Zgjedhor Komunal pas pranimit të listës së kandidatit, përkatësisht të kandidatëve, kontrollon nëse e njëjta është paraqitur në afatin e përcaktuar dhe e përpiluar në pajtim me Statutin e BDI dhe këtë Rregullore.

Nëse Komisioni Zgjedhor Komunal konstaton që lista është paraqitur në afatin e caktuar dhe është përpiluar në pajtim me Statutin e BDI-së dhe këtë Rregullore, listën e paraqitur do ta vërtetojë me vendim dhe të njëjtën e dorëzon në KZP.

## **SHPALLJA E LISTAVE TË VËRTETUARA**

### **Neni 32**

(1) Komisioni Zgjedhor Partiak, listën unike të vërtetuar për kandidatë për zgjedhje të kryetarit të Këshillit Vendor dhe Anëtarëve të Kryesisë së Këshillit Vendor do ta shpallë më së voni 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në “Faqen zyrtare të BDI”.

## **V.1 ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KRYESISË SË DEGËS**

### **Neni 33**

Të drejtën e kandidimit në zgjedhjet për anëtarë të Kryesisë së Degës kanë të gjithë anëtarët e BDI-së të regjistruar, nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës dhe që së paku janë një vit anëtar të BDI dhe që i plotësojnë kushtet e parapara më këtë Rregullore.

### **Neni 34**

Anëtarët e Kryesisë së Degës zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, të fshehta, brenda-partiake, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e BDI-së nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës, të cilët janë të regjistruar në listën zgjedhore të BDI-së, në bazë të regjistrimit për anëtarësim të realizuar në përputhje më dispozitat e Statutit, të Rregullores dhe akteve tjera nënstatutore të Partisë.

### **Neni 35**

Zgjedhja për anëtar të Kryesisë së Degës të BDI-së realizohet me votim të fshehtë, duke zbatuar parimin një anëtar - një votë.

KZP me akt të posaçëm përcakton numrin e anëtarëve të Kryesisë së Këshillit Vendor dhe të Kryesisë së degës duke marrë parasysh nenin 18 të statutit të BDI-së për përfaqësim të drejtë vendor dhe gjinor.

Në paragrafin një (1) të këtij neni nuk përfshihet kryetari i Degës dhe kryetari i Forumit Rinor.

Anëtar i zgjedhur i Kryesisë së Degës të BDI-së llogaritet kandidati i cili i plotëson të gjitha kriteret e parapara në aktin e veçantë të KZP-së për zgjedhjet në nivel komunal dhe lokal.

## **2. Kriteret e kandidatit për anëtar të Kryesisë së Degës të BDI-së**

### **Neni 36**

Të drejtën e kandidimit në zgjedhjet për anëtarë të Kryesisë së Degës kanë të gjithë anëtarët e BDI-së të regjistruar, nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës dhe që i plotësojnë kushtet e parapara me këtë Rregullore.

### **Neni 37**

Për anëtar të Kryesisë së Degës së BDI-së mund të kandidohet secili person i cili së paku një vit është anëtar i BDI-së dhe nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse.

## **VI.1. ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË DEGËS**

### **Neni 38**

Të drejtën e kandidimit në zgjedhjet për kryetar të Degës kanë të gjithë anëtarët e BDI-së të regjistruar, nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës dhe që i plotësojnë kushtet e parashikuara me këtë Rregullore.

### **Neni 39**

Kryetari i Degës zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta, të fshehta, brendapartiake, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e BDI-së nga vendbanimi, i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse – Këshilli Vendor përkatës, të cilët janë të regjistruar në listën zgjedhore të BDI-së, në bazë të regjistrimit aktiv për anëtarësim të realizuar në pajtim me dispozitat e Statutit, të Rregullores dhe akteve tjera nënstatutore të Partisë.

### **Neni 40**

Zgjedhja për kryetar të Degës së BDI-së realizohet me votim të fshehtë, duke zbatuar parimin një anëtar - një votë.

Kryetar i Degës të BDI-së llogaritet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve që kanë dalë në zgjedhje ditën e votimit dhe jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të BDI-së të regjistruar në listën zgjedhore të anëtarësisë, në degën përkatëse.

## **VI.2. Kriteret e kandidatit për kryetar të Degës së BDI-së**

### **Neni 41**

Për kryetar të Degës së BDI-së mund të kandidojë secili person i cili së paku një vit është anëtar i BDI-së dhe nga vendbanimi i cili përfshihet në territorin e degës përkatëse.

### **VI.3. PROCEDURA E KANDIDIMIT**

#### **Neni 42**

Në afat prej 20 ditëve para mbajtjes së zgjedhjeve për Kryetar të Degës të BDI-së, anëtarët e BDI-së e dorëzojnë në KZP kandidaturën e tyre për kryetar të Degës së BDI-së.

Kandidatura për kryetar të Degës së BDI-së dorëzohet me anë të formularit të veçantë drejtpërdrejtë në KZP, me bashkëngjitje të biografisë personale dhe partiake dhe programit të punës për periudhën katër vjeçare.

Për secilën kandidaturë nevojitet pëlqim me shkrim (deklaratë) e kandidatit për pranim të kandidaturës, që është e përvokueshme.

#### **Neni 43**

Komisioni Zgjedhor Partiak pas pranimit të listës së kandidatit, përkatësisht kandidatëve, kontrollon nëse e njëjta është paraqitur në afatin e përcaktuar dhe e përpiluar në pajtim me Statutin e BDI dhe këtë Rregullore.

Nëse Komisioni Zgjedhor Partiak konstaton se lista është paraqitur në afatin e caktuar dhe është në pajtim me Statutin e BDI-së dhe këtë Rregullore, listën e paraqitur do ta vërtetojë me vendim të posaçëm.

### **SHPLLJE E LISTAVE TË VËRTETUARA**

#### **Neni 44**

(1) Komisioni Zgjedhor Partiak, listën unike të vërtetuar për kandidatë për Kryetar të Degës dhe Anëtarëve të kryesisë së Degës do ta shpallë më së voni 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në “Faqen zyrtare të BDI”.

### **VII. FUSHATA ZGJEDHORE**

#### **VII.1. Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore**

#### **Neni 45**

1. Fushatë zgjedhore konsiderohet grumbullimi publik dhe ngjarje të tjera publike të organizuara nga ana e pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore, vendosja publike e afisheve, video prezantime në vende publike, prezantim zgjedhor në media dhe internet, shpërndarja

e materialeve të shtypura dhe paraqitja publike e kandidatëve të vërtetuar nga organet kompetente zgjedhore dhe programet e tyre.

2. Fushata zgjedhore fillon 10 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe nuk guxon të vazhdojë edhe në ditën e zgjedhjeve.
3. Paraqitësi i listës përkatësisht kandidati mund të parashtrojë kundërshtim për mosrespektimin e dispozitave nga paragrafët (1) dhe (2) i këtij neni.
4. Komisioni Zgjedhor Partiak e ka për detyrë t'i shqyrtojë të dhënat, të veprojë sipas kundërshtimit të parashtruar dhe ta arsyetojë vendimin e vet në afat prej 24 orësh nga dita e parashtrimit të Ankesës.

## **VIII. REALIZIM I ZGJEDHJEVE**

### **VIII.1. Mjete për realizimin e zgjedhjeve**

#### **Neni 46**

1. Mjetet për realizimin e zgjedhjeve sigurohen nga Buxheti BDI dhe me to menaxhon Komisioni Zgjedhor Partiak.
2. Mjetet e dedikuara për zgjedhjet shërbejnë për mbulim të shpenzimeve lidhur me proceset zgjedhore për sigurimin e materialit zgjedhor.

### **VIII.2. Materiali zgjedhor**

#### **Neni 47**

Materiali zgjedhor për realizimin e zgjedhjeve përbëhet nga:

- kutitë e votimit dhe 'dhoma e fshehtë' ku votohet,
- formularët e procesverbaleve dhe ditari i punës së këshillit zgjedhor,
- blloku me fletëvotime sipas ekstraktit të Listës zgjedhore,
- lista e kandidatëve,
- ekstrakti i nënshkruar i Listës zgjedhore,
- kartelat elektronike të anëtarëve të regjistruar në listën zgjedhore
- material tjetër i nevojshëm për votim.

### **VIII.3. Dorëzim i materialit zgjedhor**

#### **Neni 48**

(1) Komisioni Zgjedhor Partiak materialin zgjedhor ua dorëzon Komisioneve Komunale Partiake, më së voni në afat prej 48 orësh para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

(2) Për dorëzimin e materialit zgjedhor përpilohet procesverbali, në të cilin posaçërisht duhet të shënohet numri i përgjithshëm i fletëvotimeve me numrat serik dhe numri i duhur i listave të kandidatëve që vendosen në hapësirat e votimit.

#### **Neni 49**

- (1) Komisioni Komunal Zgjedhor ka për detyrë që një ditë para ditës së caktuar për mbajtje të zgjedhjeve, materialin zgjedhor t'ua dorëzojë këshillave vendore zgjedhore në territorin e Komunave përkatëse.
- (2) Për dorëzimin e materialit zgjedhor nga Komisioni Komunal Zgjedhor në Komisionin Zgjedhor Vendor, përpilohet procesverbali ku duhet të shënohet numri i përgjithëshëm i fletëvotimeve me numrat serik dhe materiali tjetër i nevojshëm për votim.
- (3) Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e këshillit zgjedhor vendor dhe anëtari i Komisionit Zgjedhor Komunal i cili e dorëzon materialin.
- (4) Nëse përfaqësuesit e pranishëm të paraqitësve të listave kanë vërejtje për dorëzimin e materialit zgjedhor, ata kanë të drejtë t'ju mundësohet që të njëjtat të evidentohen në procesverbalin dhe të paraqesin prova në procedurën për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.
- (5) Nëse përfaqësuesve të pranishëm të parashtruesve të listave nuk u evidentohen vërejtjet nga paragrafi (4) i këtij neni në procesverbal, ata kanë të drejtë vërejtjet t'i dërgojnë në Komisionin Zgjedhor Komunal në afat prej pesë orësh pas nënshkrimit të procesverbalit.
- (6) Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor, të drejtë për të qenë të pranishëm kanë edhe vëzhguesit e autorizuar.

#### **VIII.4. Fletëvotimi**

##### **Neni 50**

- (1) Fletëvotimet shtypet në gjuhën shqipe.
- (2) Përveç në gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj, shtypen edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdorin anëtarët në atë komunë.

##### **Neni 51**

- (1) Në fletëvotim, kandidatët përkatësisht bartësit e listave, shënohen sipas renditjes së përcaktuar në listën e vetme të kandidatëve.
- (2) Fletëvotimi përmban një pjesë për votim dhe një pjesë që mbetet në bllokun amë.

#### **Për kryetar të Degës së BDI-së**

##### **Neni 52**

- (1) Pjesa nga fletëvotimi për votimin për zgjedhje të kryetarit të Degës së BDI Republikës përmban:
  - titullin e fletëvotimit, komunën dhe numrin e vendvotimit për votim në Degën e BDI
  - numrin rendor, emrin dhe mbiemrin e kandidatëve në bazë të të dhënave nga evidenca amë.
- (2) Pjesa e fletëvotimit që mbetet në koçanin e bllokut, e përmban numrin serik të fletëvotimit, komunën dhe numrin e vendvotimit.
- (3) Në titullin e fletëvotimit gjendet emblema e BDI.

#### **Për anëtarë të Kryesisë së Degëve të BDI-së**

##### **Neni 53**

(1) Pjesa e fletëvotimit për votimin për zgjedhjet për anëtarë të Kryesisë së Degëve, përmban:

- titullin e fletëvotimit, numrin e vendvotimit dhe Degën,
- numrin rendor i cili është zgjedhur me short nga KZP, emrin dhe mbiemrin e çdo kandidati të cilit i është vërtetuar kandidatura nga KZP.

(2) Pjesa e fletëvotimit që mbetet në koçanin e bllokut, përmban numrin serik të fletëvotimit, komunën dhe numrin e vendvotimit.

### **VIII.5. Vendvotimi**

#### **Neni 54**

(1) Për çdo vendvotim caktohet vendi (hapësira në objekt) ku realizohet votimi (në tekstin e mëtejme: vendvotim).

(2) Në hapësirën në vendin e përcaktuar për votim vendosen listat e kandidatëve.

#### **Neni 55**

(1) Kryetari edhe anëtarët e këshillit vendor, më së voni një orë para fillimit të votimit mblidhen në hapësirën për votim dhe vërtetojnë:

- nëse hapësira është në gjendjen e njëjtë siç e kanë lënë ditën para zgjedhjeve,
- nëse materiali zgjedhor është në gjendjen e njëjtë siç ka qenë në ditën para zgjedhjeve dhe
- nëse kutia zgjedhore është e zbrazët.

(2) Këshilli Zgjedhor përpilon procesverbalin për gjendjen e vërtetuar, të cilin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e këshillit vendor.

(3) Vërejtjet e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit zgjedhor konstatohen në procesverbal.

(4) Nëse përfaqësuesit e autorizuar të pranishëm të paraqitësve të listave kanë vërejtje, kryetari është i obliguar t'u mundësojë që të njëjtat të evidentohen në procesverbal dhe ato të paraqesin bazë në procesin për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

(5) Nëse vërejtjet e përfaqësuesve të autorizuar të pranishëm të paraqitësve të listave nga paragrafi (4) i këtij neni nuk evidentohen në procesverbal, ata kanë të drejtë që vërejtjet t'i dorëzojnë në Komisionin Zgjedhor Komunal në afat prej pesë orësh pas nënshkrimit të procesverbalit.

(6) Të drejtë për të qenë të pranishëm gjatë vërtetimit të gjendjes para fillimit të votimit kanë edhe vëzhguesit e autorizuar.

### **VIII.6. Kohëzgjatje e votimit**

#### **Neni 56**

(1) Votimi fillon në orën 8,00 dhe zgjatë pandërprerë deri në orën 19:00

(2) Në orën 19:00, vendvotimi mbyllet, ndërsa zgjedhësve të cilët gjenden në objektin ku votohet, u mundësohet të votojnë.

(3) Këshilli vendor mund ta mbyll vendvotimin edhe para përfundimit të afatit nga paragrafi (1) i të këtij neni, me pëlqim paraprak nga Komisioni Komunal Zgjedhor kompetent i zgjedhjeve, nëse kanë votuar të gjithë zgjedhësit e regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore, por nuk fillon me numërimin e votave para orës 19:00.

(4) Vendvotimet mbyllën në ora 19:00, kurse votuesve që në atë kohë ndodhen në vendvotim duhet t'u lejojehet të votojnë, përveç nëse KZP-ja me akt të veçantë nuk ka vendosur ndryshe.

### **VIII.7. Kompetencat e Komisioni Zgjedhor Vendor gjatë votimit**

#### **Neni 57**

(1) Komisioni zgjedhor vendor përkujdeset për mirëmbajtjen e rendit dhe qetësisë në vendvotime.

(2) Komisioni zgjedhor vendor mund ta largojë secilin person i cili e prish rendin dhe qetësinë në vendvotim.

#### **Neni 58**

(1) Komisioni zgjedhor vendor mund ta ndërpresë votimin, nëse në vendvotim prishet rendi deri sa i njëjti nuk vendoset.

(2) Votimi mund të ndërpritet edhe në rast të fatkeqësive kohore ose rrethanave të tjera të jashtëzakonshme.

(3) Nëse votimi është ndërprerë më shumë se një orë, votimi do të vazhdojë për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja, por jo më shumë se tri orë.

(4) Shkaqet për ndërprerjen e votimit dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së votimit shënohen në procesverbal.

### **VIII.8. Të drejtat dhe obligimet e paraqitësve të listave dhe vëzhguesve të autorizuar gjatë votimit**

#### **Neni 59**

(1) Përfaqësuesit e paraqitësve të listave, nëse kanë vërejtje për punën e Komisionit zgjedhor vendor për kohën e votimit, mund të sugjerojnë në parregullsitë, me qëllim që të njëjtat të mënjanojnë.

(2) Kryetari i Komisionit zgjedhor vendor ka për detyrë që përfaqësuesve të pranishëm të paraqitësve të listave, nëse kanë vërejtje, t'u mundësohet që ato të evidentohen në procesverbal dhe të jenë bazë në procedurën për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

(3) Nëse vërejtjet nga paragrafi (2) i këtij neni të përfaqësuesve të autorizuar të pranishëm të bartësve të listave nuk evidentohen në procesverbal, ata kanë të drejtë të njëjtat t'i dërgojnë deri te komisioni komunal i zgjedhjeve partiake në afat prej 5 orësh pas nënshkrimit të procesverbalit.

(4) Përfaqësuesit e paraqitësve të listave mund nga afërsi të drejtpërdrejtë ta ndjekin vërtetimin e identitetit të zgjedhësit i cili i qaset votimit.

### **VIII.9. Votimi**

#### **Neni 60**



(1) Votimi bëhet personalisht në vendvotimet në çdo Komunë ku mbahen zgjedhjet për zgjedhje të organeve të partisë.

(2) Votimi për person tjetër është i ndaluar,

(3) Nëse për çfarëdo shkaqe ndonjë zgjedhësi nuk i lejohet ta realizojë të drejtën e vet zgjedhore, Komisioni Zgjedhor Vendor, me kërkesë të votuesit do të plotësojë formular në dy ekzemplarë, paraprakisht i miratuar nga Komisioni Zgjedhor Partiak, në të cilin do t'i shënojë dhe arsyetojë shkaqet dhe njërin ekzemplar do t'ia jep zgjedhësit.

#### **VIII.10. Vërtetimi i identitetit të votuesit**

##### **Neni 61**

Kryetari i Komisionit Zgjedhor Vendor ose anëtari i autorizuar nga ai është i detyruar ta vërtetojë identitetin e secilit votues.

Identiteti i votuesit vërtetohet me kartelë elektronike të anëtarësimit të BDI-së.

Komisioni Zgjedhor Vendor pas verifikimit të të dhënave nga kartela e vërteton identitetin personal të votuesit me dokument të vlefshëm për identifikim (letërnjoftim ose pasaportë), e rrethon numrin e tij rendor në Fletën e Listës Zgjedhore dhe votuesi e vë nënshkrimin e tij.

Pas përcaktimit të së drejtës së votës në vendvotim, anëtari i Komisionit Zgjedhor Vendor i jep fletëvotim votuesit, ia shpjegon mënyrën e votimit dhe e udhëzon drejt 'dhomës së fshehtë' të votimit.

#### **VIII.11. Mënyrë e votimit**

##### **Neni 62**

(1) Votimi bëhet me një fletëvotim për secilin lloj të zgjedhjeve të përcaktuara me këtë Rregullorë.

(2) Fletëvotimi shkëputet nga blloku amë sipas renditjes numerike, dhe pastaj i jepet votuesit.

(3) Votuesit i sqarohet mënyra e votimit dhe i mundësohet të votojë.

(4) Votuesi voton njëkohësisht kur mbahen dy ose më shumë lloje zgjedhjesh

(5) Votuesi, voton nashtu që e rrethon numrin rendor para paraqitësit të listës, përkatësisht numrin rendor para kandidatit për të cilin është përcaktuar të votojë dhe fletëvotimin e palosur e fut në kutinë e votimit.

#### **VIII.12. Mbledhje dhe verifikim i rezultateve nga votimi nëpër vendvotimet**

##### **Neni 63**

Rezultatet nga votimi në vendvotime mblidhen dhe verifikohen nga ana e këshillit vendor në këtë mënyrë:

- numërohen fletëvotimet e papërdorura dhe pas numërimit, së pari shkëputet këndi i djathtë i poshtëm dhe pastaj futen në zarf të veçantë që mbyllet, vulozet dhe në atë shënohet numri i vendvotimit dhe numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të papërdorura,
- përcaktohet numri i përgjithshëm i votuesve të cilët kanë votuar dhe janë nënshkruar në ekstraktin e Listës zgjedhore,
- hapet kutia e votimit dhe fillon numërimi i votave,
- me short caktohet një anëtar i cili do t'i nxjerrë dhe do t'i hap fletëvotimet një nga një nga kutia e votimit dhe do t'ia jep kryetarit të këshillit vendor,
- fletëvotimi u tregohet të gjithë anëtarëve të komisionit zgjedhor vendor,
- komisionit zgjedhor vendor e vërteton nëse fletëvotimi është i vlefshëm ose jo dhe për cilën listë të kandidatëve përkatësisht për cilin kandidat është votuar, dhe
- regjistrohet vota, ndërsa fletëvotimi futet në vend përkatës dhe merret fletëvotim i ri nga kutia e votimit.

### **VIII.13. Fletëvotim i vlefshëm**

#### **Neni 64**

(1) Fletëvotim i vlefshëm konsiderohet ai fletëvotim nga i cili në mënyrë të sigurt dhe pa mëdyshje mund të konstatohet se për cilën listë të kandidatit përkatësisht listë të kandidatëve ka votuar votuesi.

(2) Fletëvotimi është i pavlefshëm nëse nuk është i plotësuar apo nëse ka të rrethuara më shumë lista të kandidatëve apo të kandidatit.

### **VIII.14. Procesverbal për votim**

#### **Neni 65**

1. Komisioni zgjedhor vendor në procesverbalin për votim i shënon të dhënat si në vijim:
  1. numrin rendor të vendvotimit;
  2. kohën e fillimit dhe përfundimit të votimit;
  3. numrin e përgjithshëm të votuesve në vendvotim sipas ekstraktit të Lista zgjedhore;
  4. numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të cilët kanë votuar;
  5. numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të futura në kutinë e votimit;
  6. numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve që nuk janë përdorur;
  7. numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pavlefshme; dhe
  8. numrin e përgjithshëm të votave që i ka fituar secila listë e kandidatëve ndaras.

(2) Procesverballi ka një pjesë të posaçme tabelare në të cilën mblidhen dhe verifikohen rezultatet e vendvotimit.

(3) Në procesverbal shënohen edhe vërejtjet që janë dhënë nga anëtarët e këshillit vendor ose përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave në lidhje me parregullsi eventuale konkrete gjatë votimit dhe konstatimit të rezultateve, që duhet të jenë të përshkruara konkretisht.

#### **Neni 66**

- (1) Procesverbalin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e Komisionit zgjedhor vendor.

(2) Procesverbali është i vlefshëm nëse është i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të Komisionit zgjedhor vendor, nënshkrimet e të cilëve janë të deponuar.

(3) Kryetari i Komisionit zgjedhor vendor duhet t'i shënojë arsyet për mosnënshtrimin të procesverbalit nga ndonjë anëtar i Komisionit zgjedhor vendor.

(4) Nëse procesverbali nuk është i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të Komisioni zgjedhor vendor, procesverbalin e përpilon dhe e nënshkruan komisioni komunal zgjedhorë, në bazë të materialit të përgjithshëm zgjedhor.

(5) Kryetari i Komisionit zgjedhor vendor e ka për detyrë që përfaqësuesve të pranishëm të paraqitësve të listave, nëse kanë vërejtje t'u mundësojë që ato të evidentohen në procesverbal dhe të jenë bazë në procedurën për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes.

(6) Nëse vërejtjet e përfaqësuesve të paraqitësve të listave nga paragrafi (5) i këtij neni, nuk janë të evidentuara në procesverbal, ata kanë të drejtë t'i dorëzojnë në komisionin komunal të zgjedhjeve në afat prej pesë orësh nga përpilimi i procesverbalit dhe këto vërejtje mund të jenë bazë për kundërshtim.

### **VIII.15. Dorëzimi i materialit zgjedhor pranë Komisionit Komunal të Zgjedhjeve**

#### **Neni 67**

(1) Procesverbalet dhe materialin tjetër zgjedhor, Komisioni zgjedhor vendor i dorëzon në Komisionin komunal zgjedhor në afat prej 5 orësh pas përfundimit të votimit.

(2) Një ekzemplar nga procesverbalet që bëhen si kopje nën letër kopjative i jepet secilit përfaqësues të paraqitësve të listës dhe vëzhguesve të akredituar. Ekzemplari origjinal që paraprakisht është me vulë të Komisionit Zgjedhor Partiak dërgohet në Komisionin Komunal Zgjedhor.

(3) Komisioni Zgjedhor Vendor menjëherë pas përfundimit të procedurave nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, i kumton rezultatet nga votimi i kryer në atë vendvotim.

(4) Materialin zgjedhor e dorëzon në Komisionin Komunal Zgjedhor kryetari i Komisionit zgjedhor vendor i shoqëruar nga anëtarët e interesuar të komisioni zgjedhor vendor apo nga përfaqësuesit e paraqitësve të listave

(5) Për dorëzimin e materialit nga paragrafi (1) i këtij neni, përpilohet procesverbal i veçantë.

### **VIII.16. Grumbullimi dhe verifikimi i rezultateve nga votimi për zgjedhje të kryetarit të Degës dhe Kryesisë së Degës**

#### **Neni 68**

(1) Komisioni zgjedhor komunal në afat prej pesë orësh nga pranimi i materialit të përgjithshëm zgjedhor nga komisionet zgjedhore vendore i mbledh rezultatet e votimit për listën e kandidatëve nga vendvotimet për të cilat është kompetent dhe i dorëzon në Komisionin Zgjedhor Partiak.

(2) Për punën e vet, komisioni komunal zgjedhor përpilon procesverbal.

(3) Në procesverbalin për votimin futen të dhëna për votat e mbledhura nga votimi, numrin rendor të vendvotimeve në komunën për të cilën është kompetent, numrin e

përgjithshëm të votuesve për ato vendvotime të regjistruar në ekstraktet e Listës zgjedhore, numrin e përgjithshëm të votuesve të cilët kanë votuar, numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pavlefshme dhe numrin e përgjithshëm të votave që i ka fituar secila listë e kandidatëve nga vendvotimet për të cilat ai Komision komunal zgjedhor është kompetent.

(4) Në procesverbal shënohen edhe vërejtjet që i kanë dhënë anëtarët e komisionit komunal zgjedhor.

#### **Neni 69**

(1) Procesverbalin nga neni 56 e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e komisionit zgjedhor komunal.

(2) Procesverbali është i vlefshëm nëse është i nënshkruar nga shumica e anëtarëve të komisionit zgjedhor komunal.

(3) Kryetari i komisionit zgjedhor komunal partiak e ka për detyrë që t'i shënojë arsyet për mosnënshkrimin e procesverbalit nga ana e ndonjë anëtari të komisionit.

(4) Kryetari i komisionit zgjedhor komunal e ka për detyrë që përfaqësuesve të pranishëm të paraqitësve të listave nëse kanë vërejtje, t'u mundësojë që të njëjtat të evidentohen në procesverbal dhe të jenë bazë në procedurën për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore.

(5) Ekzemplar të procesverbalit merr edhe secili përfaqësues i paraqitësit të listës dhe vëzhguesit e autorizuar.

#### **Neni 70**

(1) Për kryetar Dege është zgjedhur kandidati i cili ka fituar shumicën e votave nga numri i anëtarëve të cilët kanë votuar, nëse kanë votuar më shumë se 1/3 e anëtarëve të regjistruar në Listën Zgjedhore.

### **VIII.17. Verifikimi i rezultateve**

#### **Neni 71**

(1) Komisioni Zgjedhor Partiak i mbledh dhe i verifikon rezultatet e përgjithshme nga votimi veç e veç në çdo degë të BDI-së.

(2) Komisioni Zgjedhor Partiak, rezultatet nga votimi i konstaton në bazë të procesverbaleve me rezultatet e mbledhura nga komisioni kompetent komunal Partiak dhe nga materiali i përgjithshëm i zgjedhjeve.

#### **Neni 72**

(1) Komisioni Zgjedhor Partiak për verifikimin e rezultateve të votimit përpilon procesverbale.

(2) Në procesverbal shënohen të dhënat për rezultatet nga votimi:

- numri i përgjithshëm i vendvotimeve në çdo Degë;
- numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në ekstraktet e listës zgjedhore për njësinë zgjedhore;

- numri i përgjithshëm i votuesve të cilët kanë votuar;
- numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme;
- numri i përgjithshëm i votave që i ka fituar secila listë e kandidatëve veçmas;
- numri i vendeve të fituara për anëtar të degës nga lista e kandidatëve dhe
- emri dhe mbiemri i kandidatëve të zgjedhur.

### **VIII.18. Publikimi i rezultateve nga zgjedhjet Komisioni Zgjedhor Partiak**

#### **Neni 73**

(1) Komisioni Zgjedhor Partiak, rezultatet e para të zgjedhjeve për Kryetar Dege dhe kryesi të Degës që i fiton në formë elektronike i publikon në mënyrë suksesive, ndërsa rezultatet në bazë të të dhënave nga procesverbalet e komisioneve zgjedhore komunale, përkatësisht Komisioni Zgjedhor Komunal në afat prej 12 orësh, pas përfundimit të zgjedhjeve.

(2) Komisioni Zgjedhor Partiak, i publikon menjëherë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, ndërsa më së voni në afat prej 24 orësh nga dita e verifikimit të tyre.

### **Komisioni Zgjedhor Komunal**

#### **Neni 74**

(1) Komisioni Zgjedhorë Komunal rezultatet e para të zgjedhjeve për kryetar të këshillit vendor dhe anëtar të këshillave vendore, i shpall në afat prej shtatë orësh pas përfundimit të zgjedhjeve, në bazë të të dhënave nga Komisionet zgjedhore vendore dhe ato i kumton në tabelën e shpalljeve në zyrat e Degës së Partisë.

(2) Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për zgjedhjeve për kryetar të këshilli vendor dhe anëtar të këshillave vendore, komisionet komunale partiake përkatësisht Komisioni i publikojnë menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 24 orësh nga verifikimi i tyre.

## **IX. VENDVOTIMET**

#### **Neni 75**

Me vendvotim, sipas kësaj Rregullore, nënkuptohet vendbanim ose pjesë e ndonjë vendbanimi ku votuesi nga ai rajon e realizojnë të drejtën e tyre të votës.

### **IX.1. Kriteret për përcaktim të vendvotimeve**

#### **Neni 76**

(1) Vendvotimet përcaktohen për vendbanime, ose për pjesë të vendbanimeve në të cilat ka votues të regjistruar në ekstraktet e listave zgjedhore për vendbanimet ose për pjesët e vendbanimeve.

### **Neni 77**

(1) Numri i votuesve të cilët votojnë në vendvotime përcaktohet në mënyrë me të cilën mundësohet që votimi të zhvillohet pa ndërprerje në kohën e caktuar për votim.

(2) Numri i zgjedhësve të cilët votojnë në vendvotim nuk mund të jetë më i madh se 400 votues.

### **Neni 78**

(1) Komisioni zgjedhor komunal më së voni pesë ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, do t'i shpall në vend të dukshëm përshkrimet e vendvotimeve, që janë përcaktuar për votim me shënimin nga cili rajon zgjedhësit do të votojnë në vendvotim të caktuar.

## **IX.2. Kushte për funksionim të vendvotimeve**

### **Neni 79**

(1) Çdo vendvotim ka numër rendor.

(2) Numri rendor i vendvotimit vendoset në objektin në të cilin mbahet votimi për atë vendvotim, e nëse në një objekt bëhet votimi në dy ose më shumë vendvotime, numri rendor i vendvotimit shënohet edhe në secilën hapësirë që është e përcaktuar për votim në atë vendvotim.

### **Neni 80**

(1) Votimi mbahet në hapësirë të mbyllur, që i plotëson kushtet për realizimin e votimit personal, të lirë dhe të fshehtë të zgjedhësve.

(2) Në lokalit ku mbahet votimi, shënohen emrat e vendbanimeve dhe të pjesëve të vendbanimeve (rrugët dhe pjesë të rrugëve), të cilat i përfshinë vendvotimi (përshkrimi).

(3) Mjedisi i caktuar për votim është i pajisur me 'dhomën e fshehtë' përkatësisht me kabina, apo me rrethoja ose perde në mënyrë që të mos mund të shihet si voton anëtari.

(4) Çdo vendvotim duhet të jetë i pajisur me stilolaps për nevojat e zgjedhësve gjatë votimit.

(5) Në hapësirën për votim vendosen kuti për votim të prodhuara nga material i fortë, të cilat u dorëzohen këshillave vendore.

(6) Hapësirat e përcaktuara për votim duhet të jenë të rregulluara në mënyrë përkatëse profesionale-teknike me qëllim të mbylljes dhe vulosjes së tyre.

## **X. MBROJTJE E SË DREJTËS ZGJEDHORE**

### **Neni 81**

(1) Kundërshtimet dhe ankesat për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore dërgohen në Komisionin Zgjedhor Partiak

(2) Kundërshtimet parashtrihen në formë të shkruar dhe përmbajnë:

- vendin, kohën, përshkrimin e shkeljes, kryerësin dhe provat të cilave iu referohet parashtruesi;
- emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e parashtruesit të kundërshtimit, përkatësisht të

- përfaqësuesit të autorizuar dhe
- kuti postare elektronike për pranim e shkresave.

(3) Dërgimi i kundërshtimit me postë nuk lejohet.

(4) Dërgimi i vendimeve të Komisionit Zgjedhor Partiak e që janë miratuar lidhur me kundërshtimet për mbrojtjen e të drejtave zgjedhore bëhet me shpallje publike nëpërmjet faqes zyrtare të BDI-së.

Vendimi vlerësohet që është dërguar në afat prej pesë orësh pas shpalljes në faqen e BDI-së në internet për palën dhe të gjithë personat tjerë që kanë interes juridik, që mënyra e tillë e dërgimit konsiderohet si dërgim i rregull.

## **X.1. Vendimmarrje e Komisionit Zgjedhor Partiak**

### **Neni 82**

(1) Komisioni Zgjedhor Partiak për kundërshtime të parashtruara vendos me vendim me të cilin kundërshtimin mund ta hedh poshtë, refuzojë ose miratojë.

(2) Vendimi me të cilin vendoset, duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me të gjitha të dhënat nga kundërshtimi.

(3) Kundërshtimi hidhet poshtë në qoftë se nuk është parashtruar me kohë, nuk është i lejuar, është parashtruar në mënyrë joadekuate, është parashtruar nga parashtrues i paautorizuar.

(4) Vendimet për Kundërshtim miratohen në afat prej 24 orësh.

## **X.2. Procedurë për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore të paraqitësve të listave**

### **Neni 83**

(1) Secili paraqitës i listës së kandidatëve në procedurën për votim, mbledhjen dhe verifikimin e rezultateve të votimit mund të parashtrojë kundërshtim në Komisionin Zgjedhor Partiak.

(2) Kundërshtimi nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtrohet në afat prej 24 orësh pas përfundimit të votimit, ndërsa kundërshtimi për procedurën e mbledhjes dhe verifikimit të rezultateve parashtrohet në afat prej 24 orësh nga publikimit të rezultateve.

(3) Komisioni Zgjedhor Partiak e ka për detyrë që t'i verifikojë faktet dhe rrethanat që janë të rëndësishme për vendimmarrjen lidhur me kundërshtimin nëse atë mund ta bën sipas nevojës dhe nëpërmjet prezantimit të fakteve siç janë: dokumente, deklaratatë të palëve, këqyrje në materialin zgjedhor dhe prova të tjera. Komisioni e ka për detyrë që të marrë vendim në afat prej 48 orësh pas pranimit të kundërshtimit.

(4) Vendimi nga paragrafi (3) i këtij neni dërgohet në kutinë postare elektronike për pranim të shkresave dhe vendimi konsiderohet që është dorëzuar në afat prej pesë orësh nga dorëzimi në kutinë postare elektronike.

## **X.3. Procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore të zgjedhësve**

### **Neni 84**

(1) Secili votues, të cilit i është cenuar e drejta personale zgjedhore në procedurën e zbatimit të votimit, mund të parashtojë kundërshtim në Komisionin zgjedhor Partiak në afat prej gjashtë orësh nëpërmjet postës elektronike ose personalisht.

(3) Komisioni Zgjedhor partiak e ka për detyrë që të marrë vendim në afat prej dy orësh pas pranimit të kundërshtimit.